

RAPORT VJETOR 2024

Vendimi: Nr. *1/25*

Bordi i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A. njëzëri miratoi Raportin Vjetor për vitin 2024 në mbledhjen Nr. 19 të mbajtur më datë 13.03.2025

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri:	Agron STATOVCI Kryeshef Ekzekutiv	Jetmir NUKA Kryesuesi i BD
Nënshkrimi:		
Data:	14.02.2025	13.03.2025

RAPORT VJETOR 2024



**Fushë Kosovë,
Mars 2025**

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	4
II.	RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE	5
II.1.	Aktivitetet dhe performanca e Ndërmarrjes	6
II.2.	Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenden	8
II.3.	Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutivë	9
II.4.	Komitetet e Bordit të Drejtorëve	10
III.	FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	12
III.1	Ngjarjet kryesore të vitit	13
IV.	PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE	14
IV.1.	Transporti i mallrave	14
IV.2.	Transporti i udhëtarëve	18
IV.3.	Mirëmbajtja e mjeteve lëvizëse	21
V.	PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET	24
V.1.	Gjendja financiare	24
V.1.1.	Të hyrat	24
V.1.2.	Shpenzimet	25
V.1.3.	Të hyrat dhe shpenzimet operative	25
V.2.	Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas Bankës (31.12.2024)	28
V.3.	Transaksionet e realizuara	28
V.4.	Bilanci i gjendjes	30
VI.	PROJEKTET KAPITALE	31
VII.	AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT	34
VII.1.	Planifikimi dhe zhvillimi i biznesit	34
VII.2.	Koordinimi i proceseve me MMPHI, ARH dhe institucionet tjera relevante	35
VII.3.	Aktivitetet e marketingut	36
VII.4.	Shqyrtimi i mundësive për kryerjen e veprimtarisë – Shpedicion për klientët	38
VII.5.	Sfidat kryesore gjatë vitit 2024 dhe veprimet për të ardhmen	39
VIII.	STRUKTURA ORGANIZATIVE	40
IX.	PROCEDURAT GJYQËSORE	42
IX.1.	Kontestet gjyqësore	42
IX.2.	Rreziqet nga kontestet gjyqësore për vitin 2025	44
X.	PËRFUNDIM	45
I.	ANEKS RAPORTI	
I.1	Raport lidhur me sponsorimet dhe donacionet	
I.2	Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2024	
I.3	Raport i Vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve	

I. HYRJE

Gjatë gjithë vitit 2024, Ndërmarrja kishte një ecuri të njëjtë progresive, me vitin paraprak për realizimit e planit operativ dhe financiar, duke u ballafaquar me sfida shumë të mëdha, sidomos nga vonesat e ndodhura në realizimin e projektit për Modernizimin e Linjës së 10-të Hekurudhore, sesioni Jug (Fushë Kosovë – Hani i Elezit). Mirëpo, falë angazhimit të palodhshëm të tërë ekipit të HK-Trainkos Sh.A. është arritur që Ndërmarrja të arrij disa rezultate dhe të ruaj likuiditetin e saj.

Në kuadër të këtij raporti do të përfshihen aktivitetet dhe ngjarjet më të rëndësishme të Ndërmarrjes, të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2024. Raporti është ndërtuar sipas kërkesave ligjore dhe udhëzimeve të Aksionarit si dhe përmban edhe disa pjesë tjera të rëndësishme që e pasurojnë edhe më shumë këtë raport.

Në fillim të raportit është prezantuar fjala e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, ku është theksuar performanca e Ndërmarrjes bashkë me disa prej aktiviteteve të saj.

Raporti i Kryesuesit ofron informacione edhe në lidhje me kapitalin e Ndërmarrjes, politikat që ndikojnë në zhvillimin e biznesit si dhe të dhënat tjera për strukturën dhe angazhimet e Bordit.

Në vazhdim pasqyrohet raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, duke ofruar të dhëna për ngjarjet kryesore për periudhën raportuese, të dhënat për performancën operative e financiare dhe progresin në drejtim të realizimit të Planit të Biznesit. Në këtë pjesë raporti ofron të dhëna të detajuara për shpenzimet, investimet kapitale të Ndërmarrjes dhe gjithashtu një elaborim të perspektivës bashkë me rreziqet e mundshme ndikuese. Po ashtu, brenda raportit është paraqitur edhe skema organizative e stafit, si dhe një pjesë e raportit i është kushtuar çështjeve të ndryshme të lidhura me kontestet gjyqësore. Për të qenë raporti sa më i qartë dhe i kompletuar, brenda tij janë përfshirë edhe grafikone, tabela statistikore dhe skema tjera me sqarime të nevojshme.

Raporti Vjetor 2024 i HK -Trainkos Sh.A. ka të bashkëngjitur edhe shtojcën apo Aneksin 1, i cili përmban të dhëna tjera shtesë të cilat mbesin për përdorim të Aksionarit. Në këtë pjesë janë përfshirë raporti lidhur me sponsorimet dhe donacionet, Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm dhe Raporti i Vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve për vitin 2024.

II. RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Të nderuar aksionarë,

Në fillim të muajit janar të vitit 2024, Bordi i Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A. është emëruar dhe ka filluar ushtrimin e kompetencave të tij në përputhje me detyrat dhe obligimet që burojnë nga Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, si dhe nga legjislacioni tjetër përkatës për Ndërmarrjet Publike.

Gjatë kësaj periudhe, Bordi ka qenë i angazhuar me përkushtim të lartë për të arritur rezultate të prekshme në përputhje me objektivat e planifikuara dhe për të përmirësuar gjendjen e Ndërmarrjes, duke pasur parasysh sfidat që kanë rrjedhur nga problemet e trashëguara ndër vite. Këto probleme do të jenë sfiduese edhe gjatë vitit 2025.

Falë angazhimit të të gjithë drejtorëve dhe stafit menaxhues, kemi arritur sukseset e para në përmbushjen e obligimeve, duke ndërmarrë hapa të rëndësishëm për përmirësimin e gjendjes. Gjatë vitit 2024, janë arritur përmirësime të dukshme, si rezultat i masave të marra për optimizimin e shpenzimeve dhe minimizimin e humbjeve, që ka kontribuar në përmirësimin e gjendjes financiare, megjithëse ende jo në nivelin e dëshirueshëm.

Për të adresuar sfidat dhe për të mundësuar një rritje të qëndrueshme, kemi hartuar dhe venë në zbatim planin strategjik afatmesëm si dhe procesi i ristrukturimit të Ndërmarrjes, pas një pune intensive, ka përfunduar në fund të vitit 2024. Ky proces pritet të sjellë rezultate pozitive si në aspektin financiar ashtu edhe në atë operativ.

Edhe pse nuk kemi arritur ende nivele të kënaqshme në realizimin e objektivave të planifikuara, sidomos në transportin e mallrave, përmbushja e obligimeve ligjore dhe angazhimi në zhvillimin e politikave strategjike kanë qenë prioritet i Bordit. Kjo ka mundësuar mbikëqyrjen e vazhdueshme të implementimit të këtyre politikave dhe një përpjekje të pandërprerë për të siguruar një qeverisje korporative sipas standardeve më të larta.

Në vijim, ky raport do të paraqesë detaje mbi aktivitetet dhe performancën e Ndërmarrjes për vitin 2024, si dhe informacione të tjera të rëndësishme.

II.1. AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES

Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2024 janë përqendruar në realizimin e objektivave të planifikuara dhe përpjekjet për tejkalimin e pengesave dhe vështirësive të Ndërmarrjes.

Një nga sfidat kryesore gjatë periudhës raportuese ka qenë gjendja e rëndë financiare, që vazhdon të mbetet një problem i madh, si dhe mbyllja e hekurudhës në Linjën e Hanit të Elezit. Ndërmarrja është përballur gjithashtu me obligime financiare të akumuluar ndër vite ndaj partnerëve dhe institucioneve të tjera, të cilat nuk kanë mundur të përmbushen, megjithatë gjatë vitit 2024 nuk janë krijuar obligime të reja.

Ndërprerjet e transportit hekurudhor për shkak të punimeve në rehabilitimin e Linjës së 10-të Hekurudhore kanë ndikuar në paralizimin e transportit ndërkombëtar të mallrave dhe të udhëtarëve, duke përfshirë edhe transportin e mallrave për NewCo Ferronikeli-n. Në transportin vendor të udhëtarëve është mbajtur në operim vetëm Linja e Pejës me katër trena në ditë, dy në shkuarje dhe dy në ardhje.

Përkundër këtyre sfidave, Bordi i Drejtorëve është angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për të adresuar këto vështirësi dhe për të dalë nga kjo situatë, megjithatë këto vështirësi do të mbeten një sfidë edhe për të ardhmen.

Gjatë vitit 2024, Bordi është angazhuar në zbatimin e rekomandimeve të auditorëve për gjetjet nga auditimi i vitit paraprak. Po ashtu, janë përgatitur dhe hartuar dokumente strategjike dhe politika tjera të cilat do të orientojnë zhvillimin e Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A.

Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2024

Përkushtimi kryesor gjatë vitit 2024 ka qenë realizimi i objektivave të përcaktuara në Planin e Biznesit. Mirëpo, përkundër kësaj, objektivat e planifikuara nuk janë realizuar plotësisht për shkak të pengesave të lartpërmendura. Megjithatë, ka pasur përmirësime të dukshme në disa aspekte të aktivitetit të Ndërmarrjes krahasuar me vitin paraprak.

Për të arritur qëllimet, janë ndërmarrë veprime për të adresuar dhe tejkaluar pengesat që kanë ndikuar në performancën e Ndërmarrjes. Me Menaxherin e Infrastrukturës, janë zhvilluar takime dhe kontakte për të mundësuar që Linja e Hanit të Elezit të funksionojë gjatë punimeve, sipas një orari të përshtatshëm.

Po ashtu, hartimi dhe rishikimi i politikave të Ndërmarrjes ka vazhduar, duke pasur efekte pozitive në organizimin dhe strukturimin e brendshëm të punëve. Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare ka qenë gjithashtu një prioritet i Bordit.

Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual

Për sa i përket performancës operative dhe financiare, viti 2024 nuk mund të konsiderohet një

vit i kënaqshëm për Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A. Ndërkohë që janë shënuar disa përmirësime, mirëpo objektivat e planifikuara nuk janë arritur plotësisht.

Transporti i Mallrave

Performanca operative e financiare në transportin e mallrave nuk është arritur, qoftë në krahasim me planifikimin ashtu edhe në raport me realizimin nga viti paraprak, pasi që nuk ka pasur transport për shkak të mbylljes së Linjës së 10-të Hekurudhore.

Transporti i Udhëtarëve

Në transportin e udhëtarëve, performanca operative ka arritur një realizim prej 84.67%, e cila është 0.81% më e ultë krahasuar me vitin paraprak. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se numri i udhëtarëve ka qenë më i lartë, megjithatë ende nuk është implementuar një mekanizëm për të llogaritur edhe udhëtarët që kanë përfituar nga transporti pa pagesë.

Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e Ndërmarrjes

Një nga sfidat kryesore mbetet modernizimi i parkut të mjeteve lëvizëse. Mjetet aktuale janë të vjetra dhe kanë shpenzime të larta për mirëmbajtje dhe operim, që ndikojnë në rritjen e kostos së përgjithshme. Kjo është si pasojë e buxhetit të kufizuar të Ndërmarrjes.

Investimet në modernizimin e rrjetit hekurudhor janë të domosdoshme për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit, por këto investime duhet të shoqërohen edhe me investime në mjete lëvizëse, për të siguruar rritjen e efikasitetit dhe performancës operacionale.

Po ashtu, hartimi i politikave strategjike për zhvillimin e Ndërmarrjes mbetet një prioritet. Bordi është angazhuar për të ndërmarrë nismat që janë në përgjegjësi të tij, për të dhënë shtytje projekteve dhe për t'i çuar ato drejt realizimit.

Një tjetër aspekt që kërkon vëmendje është përgatitja profesionale e kuadrove. Fokusi do të jetë në zhvillimin e iniciativave për hapjen e drejtimeve shkollore përkatëse në Kosovë dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve.

Të priturat për vitin e ardhshëm

Një nga synimet kryesore për vitin 2025 është investimi në modernizimin e mjeteve lëvizëse dhe blerjen e mjeteve të reja. Ky është një mision i vështirë, por me mbështetje nga Aksionari dhe mundësitë për gjetjen e donatorëve dhe formave të tjera të financimit, shpresojmë që do të realizohet. Për këtë qëllim, bazuar në Planin Strategjik-Investiv si dhe në Strategjinë e Transportit Multimodal, do të angazhohemi për gjetjen burimeve për investime në mjetet lëvizëse krahas me zhvillimet në infrastrukturën hekurudhore.

Sfidat me të cilat ballafaqohemi, vitin e ardhshëm do të jenë ndikuese edhe në arritjen e objektivave të parapara në planin e biznesit për vitin 2025. Problemet e ndërprerjes së transportit për shkak të punimeve që janë duke u zhvilluar në Linjën e 10-të Hekurudhore do të jenë çështja më sfiduese për zhvillimin e punës dhe të projekteve të Ndërmarrjes. Po ashtu edhe obligimet e larta financiare të akumuluar ndër vite do të jenë sfiduese.

II.2. INFORMACIONE LIDHUR ME KAPITALIN DHE DIVIDENTEN

Gjatë vitit 2024, Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A. nuk kanë nënshkruar ndonjë marrëveshje të re kreditore, por vazhdojnë të mbajnë obligimet e marra nga marrëveshja kredituese e vitit 2022 me ish-Ministrinë e Financave. Kredia për likuiditetin e urgjencës së infrastrukturës vitale, në shumën e 364,963.00€, mbetet ende aktive dhe e papaguar.

Për sa i përket mjeteve të buxhetit të ndara për projektet kapitale nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2024, në shumën e 489,275.00€, ato janë shfrytëzuar në shkallën prej 84.02%. Ky shfrytëzim ka kontribuar në realizimin e disa projekteve të rëndësishme, përfshirë riparimin e mesëm të pesë (5) vagonëve të udhëtarëve. Ky projekt pritet të jetë funksional gjatë vitit 2025 dhe të ketë një ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e kapaciteteve operative të Ndërmarrjes.

Sa i përket shpërndarjes së dividendës, Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A. nuk kanë arritur nivelin e realizimit të fitimit që do të mundësonte ndarjen e dividendës, sipas rregulloreve dhe akteve juridike që e rregullojnë këtë proces. Ky është një aspekt që do të kërkojë përmirësim dhe rritje të performancës financiare në periudhën e ardhshme, për të arritur në përmbushjen e objektivave të planifikuara dhe krijimin e mundësive për shpërndarjen e dividendës në të ardhmen.

II.3. TË DHËNAT PËR DREJTORËT JOEKZEKUTIVË

Në këtë pjesë të raportit, pasqyrohen të dhënat për drejtorët joekzekutivë të angazhuar gjatë vitit 2024, duke përfshirë gjithashtu pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve.

Bordi i Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A. është emëruar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/182, datë 10.01.2024. Në përputhje me këtë vendim dhe në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve ka ushtruar kompetencat e tij në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi që dalin nga ligjet dhe rregulloret e tjera të aplikueshme për ndërmarrjet publike.

Gjatë vitit 2024, Bordi ka mbajtur gjithsej shtatëmbëdhjetë (17) mbledhje, përfshirë këtu edhe Mbledhjen e Kuvendit Vjetor të Aksionarëve. Gjatë këtyre mbledhjeve, janë diskutuar çështje kyçe për zhvillimin e Ndërmarrjes dhe për zgjidhjen e problemeve të ngërthiera nga vitet e kaluara.

Në vijim, pasqyrohen të dhënat e detajuara për strukturën dhe mbledhjet e Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2024, përfshirë edhe pjesëmarrjen e zyrtarëve tjerë në këto mbledhje.

Të dhënat për strukturën dhe mbledhjet e Bordit të Drejtorëve për vitin 2024:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
1	Jetmir Nuka	Kryesues	17
2	Vjollca Salihu	Anëtare	17
3	Luljeta Lutfiu	Anëtare	17
4	Ruzhdi Zeqiri	Anëtar	16
5	Kimete Fazliu	Anëtare	17
6	Afrim Bulluti	Anëtar	15
7	Agron Statovci	Kryeshef Ekzekutiv	17
8	Besarta Rrahmani	U.D. ZKFTH	7
9	Burim Bylygbashi	ZKFTH	9
10	Afrim Kuleta	Sekretar	17

II.4. KOMITETET E BORDIT TË DREJTORËVE

Për të siguruar përmbushjen e obligimeve ligjore dhe për të arritur një performancë optimale të Ndërmarrjes, Bordi i Drejtorëve ka krijuar komitete të cilat kanë ndihmuar në menaxhimin e disa prej çështjeve dhe detyrave të tij. Komitetet kanë pasur një rol të rëndësishëm në përmirësimin e eficiencës dhe përmbushjen e qëllimeve strategjike të Ndërmarrjes.

Përveç komiteteve të Bordit, gjithashtu edhe Komisioni i Auditimit, i cili është formuar nga Aksionari në bazë të Vendimit Nr. 01/724, të datës 29.01.2024, ka pasur një rol të rëndësishëm në monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve financiare të Ndërmarrjes.

Gjatë vitit 2024 janë mbajtur gjithsej shtatëmbëdhjetë (17) mbledhje të Komisionit të Auditimit, gjashtë (6) mbledhje të Komitetit për Staf dhe Shpërblime dhe pesë (5) mbledhje të Komitetit për Hulumtime dhe Teknologji. Çdo komitet ka pasur një përqendrim të veçantë në aspekte të ndryshme të punës së Ndërmarrjes, duke kontribuar në një menaxhim më të strukturuar dhe të koordinuar.

Në vijim, pasqyrohen detajet për përbërjen, funksionimin dhe mbledhjet e mbajtura nga këto komitete gjatë vitit 2024.

Të dhënat për strukturën dhe mbledhjet e Komisionit të Auditimit për vitin 2024:

Komiteti (koha e funksionimit)	Emri dhe Mbiemri		Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
KOMISIONI I AUDITIMIT 29.01.2024 - aktiv	1	Ruzhdi Zeqiri	Kryesues	16
	2	Kimete Fazliu	Anëtare	17
	3	Luljeta Lutfiu	Anëtare	17
	4	Armend Shehu	U.D. ZAB	12
	5	Besarta Rrahmani	U.D. ZKFTH	3
	6	Burim Bylygbashi	ZKFTH	9
	7	Afrim Kuleta	Sekretar	17

Të dhënat për strukturën dhe mbledhjet e Komitetit për Staf dhe Shpërblime për vitin 2024:

Komiteti (koha e funksionimit)	Emri dhe Mbiemri		Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
KOMITETI PËR STAF DHE SHPËRBLIME 29.02.2024 – 29.08.2024	1	Kimete Fazliu	Kryesues	6
	2	Vjollca Salihu	Anëtare	6
	3	Agron Statovci	Anëtar	5
	4	Arbër Salihu	Këshilltar	5
	5	Afrim Kuleta	Sekretar	6

Të dhënat për strukturën dhe mbledhjet e Komitetit për Hulumtime dhe Teknologji për vitin 2024:

Komiteti (koha e funksionimit)	Emri dhe Mbiemri		Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
KOMITETI PËR HULUMTIME DHE TEKNOLOGJI 29.08.2024 – aktiv	1	Afrim Bulluti	Kryesues	5
	2	Luljeta Lutfiu	Anëtare	5
	3	Agron Statovci	Anëtar	5
	4	Altin Podrimçaku	Këshilltar	5
	6	Afrim Kuleta	Sekretar	4

Në përfundim të vitit 2024, mund të theksojmë se, pavarësisht sfidave të shumta dhe situatës financiare të vështirë, Ndërmarrja ka arritur të realizojë një sërë objektivash dhe të bëjë hapa të rëndësishëm për përmirësimin e gjendjes operative dhe financiare.

Angazhimi i Bordit të Drejtorëve, mbështetur nga punët e komiteteve të Bordit dhe angazhimi i stafit menaxhues, ka qenë vendimtar në zbatimin e masave që kontribuan në përmbushjen e kërkesave ligjore dhe strategjike. Pavarësisht sfidave të infrastrukturës dhe mbylljes së Linjës së 10-të Hekurudhore, kemi vazhduar me hartimin e politikave dhe strategjive për zhvillimin e mëtejshëm të Ndërmarrjes, dhe përpjekjet tona për ristrukturim kanë filluar të japin rezultate, megjithëse nuk janë arritur të gjitha objektivat operative dhe financiare.

Për vitin 2025, përkushtimi jonë do të jetë drejt përmirësimit të performancës financiare dhe operative, me një fokus të veçantë në modernizimin e mjeteve lëvizëse. Angazhimi për gjetjen e burimeve të financimit dhe mundësive të investimeve do të mbetet prioritet, duke u mbështetur në strategjitë e planifikuara dhe kërkesat e zhvillimit të sektorit hekurudhor në Kosovë.

Mbi të gjitha, Bordi i Drejtorëve mbetet i angazhuar për të siguruar një qeverisje të përgjegjshme dhe për të përmbushur obligimet si ndaj Aksionarit ashtu edhe ndaj të gjitha palëve të interesuara. Do të vazhdojmë të punojmë për një të ardhme të qëndrueshme dhe të suksesshme të Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A.

Në emër të Bordit të Drejtorëve të HK-Trainkos Sh.A.

Jetmir NUKA – Kryesues

III. FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Ndërmarrja HK-Trainkos Sh.A. vitin 2024 arriti që ta përmbyll me rezultate jo të mira krahasuar me vitin paraprak, por të kënaqshme krahasuar me vitet paraprake, duke marr për bazë ndikimin e shumë faktorëve të ndryshëm si: ndërprerja e plotë e linjës hekurudhore Fushë Kosovë – Hani i Elezit nga shkaku i punimeve në realizimin e projektit “Modernizimi i Linjës së 10-të Hekurudhore” si dhe ndërprerja e transportit vendor të mallrave nga klienti ynë NewCo Ferronikeli.

Nga ndikimi i faktorëve që u theksuan më lart, gjatë vitit 2024 Ndërmarrjes i janë shkaktuar probleme të mëdha, sidomos në mosrealizimin e planifikimeve të deklaruara nga ana e bashkëpunëtorëve (klientëve) tanë. Këta faktorë kanë pasur ndikim direkt në (mos) përmbushjen e parashikimeve sipas Planit të Biznesit.

Sa i përket realizimit të detyrave dhe respektimin e afateve ligjore të raportimit, Ndërmarrja ka arritur që këto obligime t’i përmbush me sukses. Trainkos Sh.A. me kohë ka hartuar Planin e Biznesit, është pajisur me licencat e nevojshme operuese nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) dhe në vazhdimësi ka raportuar tek Aksionari mbi gjendjen dhe zhvillimet në Ndërmarrje.

Puna dinamike në funksion të përshtatshmërisë të rregulloreve të brendshme me legjislacionin në fuqi ka vazhduar edhe gjatë vitit 2024, po ashtu është trajtuar edhe aspekti i përshtatshmërisë me direktivat e Bashkimit Evropian dhe rregullave ndërkombëtare të operimeve në transportin hekurudhor.

Vazhdojnë të mbetën sfidë fondet e pamjaftueshme për investime kapitale në modernizimin dhe rritjen e flotës operuese, mjetet me të cilat operojmë janë të vjetra dhe si rrjedhojë krijojnë edhe shpenzime të mëdha.

Aktualisht transporti hekurudhor ndërkombëtar është plotësisht i ndërprerë, përderisa në linjën ndërkombëtare përmes Maqedonisë së Veriut, transporti është ndërprerë nga punimet që janë duke u zhvilluar në realizimin e projektit “Modernizimi i Linjës së 10-të Hekurudhore”, transporti ndërkombëtar përmes kufirit në veri qëndron i mbyllur për arsye të njohura politike. Pamundësia e zhvillimit të transportit ndërkombëtar ka ndikuar në performancën e Ndërmarrjes dhe ka ndikuar që shumë klientë potencialë të orientojnë transportin e tyre përmes alternativa tjera.

Për të tejkaluar pengesat e shfaqura dhe për të arritur objektiva, angazhimi ynë do të jetë me fokus të veçantë në investime të vazhdueshme, të cilat do të kenë ndikim në uljen e shpenzimeve, përmirësim koherent të shërbimit dhe në drejtim të zhvillimit të vazhdueshëm të ofertës dhe rritjes së efikasitetit dhe përmirësime të dukshme dhe efikase sipas strukturës së re organizative. Struktura e re organizative, në një të ardhme të afërt do të reflekton edhe në zvogëlimin e shpenzimeve në koston e punës.

**Kryeshef Ekzekutiv
Agron STATOVCI**

III.1. NGJARJET KRYESORE TË VITIT

Ngjarjet kryesore më rëndësi të veçantë që e kanë shoqëruar Trainkos-in gjatë vitit 2024 janë të paraqitura si në vijim:

1. Ndërmarrja gjatë vitit 2024 ka kryer ristrukturim të thellë, ky hap është marrë për arsye financiare, ku janë bërë disa ndryshime të rëndësishme për të optimizuar operacionet dhe për të arritur një efektivitet më të lartë. Ristrukturimi ka përfshirë reduktimin e disa departamenteve, sektorëve dhe shërbimeve që nuk ishin më të nevojshme për funksionimin e suksesshëm të Ndërmarrjes. Kjo është bërë me qëllim të uljes së shpenzimeve dhe menaxhimit më të mirë të burimeve, duke rritur fleksibilitetin e ndërmarrjes. Për më tepër, rritja e përgjegjësisë së stafit ka qenë një tjetër aspekt i rëndësishëm i këtij ristrukturimi. Ky ndryshim ka përmirësuar komunikimin dhe bashkëpunimin mes ekipeve, duke e bërë ndërmarrjen më të gatshme për të përballuar sfidat e ardhshme.
2. Gjatë vitit 2024, është realizuar projekti për riparimin e mesëm të pesë vagonë, i cila ka përmirësuar dhe rritur kapacitetin e transportit të udhëtarëve. Ky investim ndikon në përmirësimin e kushteve të udhëtimit dhe menaxhim më efikas të fluksit të udhëtarëve, duke ofruar një shërbim më të sigurt. Kjo kontribuon në optimizimin e përdorimit të mjeteve të transportit dhe ka mundësuar rritjen e kapacitetit për t'u përballur me kërkesën për shtimin e trenave të udhëtarëve.
3. Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet tri Ndërmarrjeve Publike: Trainkos Sh.A., Infarkos Sh.A. dhe KEK (Korporata Energjetike e Kosovës). Kjo marrëveshje do të shërbejë si një mundësi strategjike për këto ndërmarrje për të shkëmbyer dhe ofruar mbështetje në fushat përkatëse të shërbimeve, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve që ne ofrojmë. Ajo do të mundësojë gjithashtu zhvillimin e sinergjive mes palëve, përmirësimin e menaxhimit dhe optimizimin e burimeve, në përputhje me interesat e përbashkëta dhe objektivat strategjike të secilës ndërmarrje.
4. Pjesëmarrja aktive në punëtoritë e organizuara nga Sekretariati për zbatimin e Traktatit për Transport, përmes ARH-së, reflekton në përmirësimin e aktiviteteve të Ndërmarrjes si pjesë përbërëse e sistemit hekurudhor dhe përshtatjen e reformave të domosdoshme për të qenë pjesë integruese e sistemit Evropian për transportin e udhëtarëve dhe mallrave. Me avancimin e proceseve përfitojnë udhëtarët që shfrytëzojnë transportin me hekurudhë dhe bizneset për transportin e mallrave në dhe nga Republika e Kosovës.

IV. PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim indikatorët fizikë të performancës operative në transportin e mallrave dhe të udhëtarëve për periudhën dymbëdhjetë mujore, nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2024. Gjithashtu, do të behët krahasimi i realizimit me planifikimin që është bërë për të njëjtën periudhë me Planin e Biznesit të vitit 2024 si dhe me realizimin e vitit paraprak 2023.

IV.1. TRANSPORTI I MALLRAVE

Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim në formë tabelore dhe përmes diagrameve performancën operative dhe financiare në transportin e mallrave për vitin 2024 si dhe të dhënat krahasuese me realizimin e vitit të kaluar, si dhe me planifikimin për vitin 2024.

Realizimi në transportin e mallrave 2024:

Përshkrimi	Sasia e Transportuar Janar – Dhjetor 2024
Realizimi Neto Ton në 2023	195,670.51 Ton
Realizimi Neto Ton në 2024	1,984.66 Ton
Planifikimi Neto Ton në 2024	500,000 Ton
Dallimi: Realizim 2024 – Realizim 2023	193,685.85 Ton
Dallimi: Realizim – Planifikim në 2024	498,015.34 Ton
Dallimi: Realizim 2024 – Realizim 2023 (%)	101.43 %
Dallimi: Realizim 2024 – Planifikim 2024(%)	0.39 %

Tabela 4.1.1

Siç mund të shihet nga tabela më lart, gjatë vitit 2024 kemi transportuar rreth 99.61% më pak se sa sasia e planifikuar për këtë periudhë dhe 99 % më pak se sa në vitin e kaluar 2023.

Transporti i mallrave me kontejnerë gjatë vitit 2024 ka qenë:

Përshkrimi	Numri i Transportuar i Kontejnerëve (Janar – Dhjetor 2024)
Kontejnerë të plotë – 2024	00.00 copë
Kontejnerë të plotë/zbrazët - 2024	00.00 copë

Tabela 4.1.2

Sasia e transportuar në Neto ton për vitin 2024:




Figura 4.1.1

Siç mund të shihet nga figura më lart, në aspektin operativ kemi arritur të realizojmë 2.29% nga planifikimi i Planit të Biznesit për vitin 2024.

Të hyrat nga transporti i mallrave për periudhën raportuese janë:

Përshkrimi	Të hyrat për periudhën (Janar - Dhjetor 2024)
Realizim shitje të hyra 2023	466,594.48
Realizim shitje të hyra 2024	10,704.61
Planifikimi 2024	1,150,000.00
Realizim 2024 - Realizim 2023	455,889.87
Realizim – Planifikim 2024	-1,139,295.39
Realizim 2024 - Realizim 2023 (%)	2.29%
Realizim – Planifikim 2024 (%)	0.93%

Tabela 4.1.3

Siç mund të shihet nga tabela më lart të hyrat nga transporti i mallrave janë realizuar në shkallë prej 0.93% të planifikimit për vitin 2024.

Të hyrat në periudhën vjetore 2023:




Figura 4.1.2

Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i mallrave:

Përshkrimi	Të hyrat dhe shpenzimet €
Shitjet nga transporti i mallrave	10,704.61 €
Të ardhura tjera nga transporti i mallrave	6,000.00 €
Total shitjet	16,704.61 €
Shpenzimet direkte në transportin e mallrave	314,351.03 €
Shpenzimet indirekte në transportin e mallrave	11,808.22 €
Total shpenzimet	326,159.25 €
Fitimi/humbja operative	309,454.64€
Fitimi/humbja në %	-18.53%

Tabela 4.1.4

Siç mund të shihet nga tabela më lart, transporti i mallrave ka pasur një humbje prej - 309,454,64€ ose për 18.53 % shpenzime më të larta se të hyrat nga transporti.

Transporti i mallrave në kostot indirekte ka marrë pjesë 1.18% të shpenzimeve totale të Ndërmarrjes, kjo vjen nga ndarja e shpenzimeve me transportin e udhëtarëve në bazë të përqindjes së marrjes pjesë me tren/kilometra në komunikacion.

Mallrat e transportuara gjatë periudhës janar – dhjetor 2024:

Gjatë vitit 2024, nga mallrat e transportuara 44%, të tyre kanë qenë transport ushtarak, 34% transport i shinave për binarë dhe 22% vagonë të zbrazët.




Figura 4.1.2

Revokimi i Trenave

Gjatë vitit 2024 ka pasur revokime të trenave të planifikuar, të cilat pasqyrohen në tabelën në vijim bashkë me vlerën e kompensimit sipas kategorive të ndara në transportin ndërkombëtar (import –eksport) dhe transport vendor.

Janar - Dhjetor 2023	Trena të revokuar me 0%	Trena të revokuar me 10%	Trena të revokuar me 20%	Trena të revokuar me 100%	Vlera në euro e revokimeve
Import-Export	314	0.00	0.00	0.00	0.00 €
Vendor	912	912	0.00	0.00	3,999.12€
Total	1226	912	0.00	0.00	0.00 €

Tabela 4.1.5

Në tabelën më lart shihet se gjatë vitit 2024 në import dhe eksport janë revokuar në total 314 trena. Nga këto revokime me kompensim 0% janë 0 trena, me 10% janë 0 trena, me 20% janë 0 trena dhe me revokime 100% janë 0 trena. Revokimet me 0% janë nga shkaku i mbylljes së Linjës së 10 Hekurudhore nga punimet që janë duke u zhvilluar në rehabilitimin e saj, për të cilat revokime nuk ngarkohemi me shpenzime nga Menaxheri i Infrastrukturës.

Po ashtu, në tabelat më lart shihet se gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024 në transportin vendor në total janë 912 trena të revokuar. Nga këto revokime, me kompensim të shumës prej 10% të qasjes në binarë janë 912 trena. Revokimi i këtyre trenave ka ndodhur për shkak se NewCo Ferronikeli nuk ka transportuar sipas planifikimit.

IV.2. TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Transporti i hekurudhor i udhëtarëve edhe gjatë vitit 2024 ka qenë i kufizuar për shkak të punimeve në rehabilitimin e Linjës së 10-të Hekurudhore, përkatësisht në Linjën e Hanit të Elezit. Gjatë këtij viti, transporti i udhëtarëve është realizuar vetëm në Linjën Prishtinë – Pejë – Prishtinë me gjashtë trena në ditë, tre në shkuarje dhe tre në ardhje.

Gjatë vitit 2024 numri i përgjithshëm i udhëtarëve të transportuar ka qenë 68,743, ndërsa shuma e të hyrave nga shitja e biletave ka qenë 59,396.71€.

Krahasuar me vitin 2023, numri i udhëtarëve në vitin 2024 është për 1,774 më i ulët, apo shprehur në përqindje është për 2.52% më pak, ndërsa krahasuar me planifikimin, numri i udhëtarëve të transportuar është për 11,257 më i ulët, apo shprehur në përqindje -14.07%. Ndërsa, realizimi financiar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është për 1959.78€ më i ulët apo 3.28%, ndërsa krahasuar me planifikimin, të hyrat për këtë periudhë raportuese janë për 3603.29€ më të ulëta, apo 5.80%.

Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim në formë tabelore të dhënat për performancën operative dhe financiare në transportin e udhëtarëve për vitin 2024 si dhe të dhënat krahasuese me ato të vitit 2023 si dhe me planifikimin për vitin 2024.

Performanca operative në transportin e udhëtarëve në vitin 2024:

Përshkrimi - Udhëtarë	Numri i udhëtarëve
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2023	70,517
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2024	68,743
Planifikimi i numrit të udhëtarëve në 2024	80,000
Dallimi: Realizim 2024 - 2023	-1,774
Dallimi: Realizim - planifikim 2023	-11,257
Dallimi: Realizim(2024 – 2023) në %	-2.52
Dallimi: Realizim – planifikim 2024	-14.07

Tabela 4.2.1

Siç shihet nga të dhënat në tabelën më lart, numri i udhëtarëve të transportuar gjatë vitit 2024 ka qenë më i ulët për 2.52% në krahasim me vitin 2023, ndërsa krahasuar me planifikimin realizimi ka qenë për 14.07% më i ulët.

Sqarim: Në numrin e përgjithshëm të udhëtarëve të transportuar nuk janë të përfshirë udhëtarët që janë të liruar nga pagesat e udhëtimit, ende nuk është krijuar ndonjë mekanizëm për evidentimin e tyre.

Performanca financiare në transportin e udhëtarëve në vitin 2024:

Përshkrimi - Shitje e Biletave	Të hyrat
Realizim shitje të hyra 2023	61,356.49
Realizim shitje të hyra 2024	59,396.71
Planifikimi 2024	63,000.00
Dallimi: Realizim 2024 - realizim 2023	1,959.78
Dallimi: Realizim - planifikim 2024	3,603.29
Dallimi: Realizim 2024 - realizim 2023 në %	-3.19
Dallimi: Realizim - planifikim 2024 në %	-5.72

Tabela 4.2.2

Siç shihet nga të dhënat në tabelën më lart, realizimi financiar nga transporti i udhëtarëve gjatë vitit 2024 ka qenë më i ulët për -3.19% në krahasim me vitin 2023, ndërsa krahasuar me planifikimin realizimi ka qenë për -5.72% më i ulët.




Figura 4.2.1

Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i udhëtarëve:

Përshkrimi - Të hyrat	
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve – OSHP - MMPHI	1,000,787.51 €
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - ME	610,725.00 €
Shitjet nga transporti i udhëtarëve	59,396.71€
Total të hyrat	1,670,909.22 €
Shpenzimet direkte në TU	868,518.02 €
Shpenzimet indirekte në TU	988,888.59 €
Total shpenzimet	1,857,407.11 €

Tabela 4.2.3




Figura 4.2.2

Siç shihet nga tabela më lart, biznesi i transportit të udhëtarëve ka operuar me një humbje operative prej -10.04% gjatë periudhës raportuese, duke llogaritur të hyrat nga OSHP-MMPHI, ME si dhe të hyrat nga shitja e biletave të udhëtarëve dhe transporteve të kontraktuara.

Vërejtje: Shpenzimet indirekte janë përlllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave duke marrë për bazë tren-kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e udhëtarëve kanë operuar rreth 98.82% nga totali i tren-kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat.

IV.3. MIRËMBAJTJA E MJETEVE LËVIZËSE - MML

Në kuadër të mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse hekurudhore përfshihen mirëmbajtja e trenave motorikë, mirëmbajtja e lokomotivave transportuese, mirëmbajtja e lokomotivave manovruese, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtareve, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave dhe punë të tjera për riparimin e vagonëve të huaj.

Realizmi i punimeve të kryera në mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse gjatë vitit 2024 është pasqyruar përmes tabelave si në vijim të këtij raporti si dhe janë bërë edhe krahasimet me realizimin në periudhën e njëjtë të vitit paraprak:

IV.3.1 Mirëmbajtja e trenave motorikë

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e trenave motorikë të realizuara në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2024	2023	Ndryshimi
1.	Servisime	0	0	0
2.	Riparime	0	0	0
3.	Kontrollime K1	0	0	0
4.	Kontrollime K3	0	0	0
5.	Kontrollime K6	0	0	0
6.	Gdhendja e rrotave	0	0	0

Tabela 4.3.1

Siç shihet nga të dhënat në tabelën më lart, gjatë vitit 2024 nuk ka pasur servisimeve të trenave motorikë për shkak se gjatë këtij viti ata nuk kanë qenë në operim.

IV.3.2 Mirëmbajtja e lokomotivave transportuese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave transportuese të realizuara në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2024	2023	Ndryshimi
1.	Servisime	390	299	+91
2.	Riparime	51	40	+11
3.	Kontrollime K1	27	18	+9
4.	Kontrollime K3	6	3	+3
5.	Kontrollime K6	9	6	+3
6.	Gdhendje te rrotave	3	3	0

Tabela 4.3.2

IV.3.3 Mirëmbajtja e lokomotivave manovruese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave transportuese të realizuara në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2024	2023	Ndryshimi
1.	Servisime	2	1	+1
2.	Riparime	9	12	-3
3.	Kontrollime K1	2	8	-6
4.	Kontrollime K3	1	2	-1
5.	Kontrollime K6	1	1	0

Tabela 4.3.3.1

Intervenimet për secilin mjet tërheqës gjatë vitit 2024:

Mjeti tërheqës	2620 005	2640 007	2640 008	2710 009	2640 010	2620 016	2760 001	2760 002	5800 004
Servisime	156	24	25	27		158	2		
Riparime	5	16	7	5	1	17	9		
Kontrollime mujore	6	7	6	1		7	2		
Kontrollime tremujore	1	2	2			1	1		
Kontrollime gjashtëmujore	2	2	2	1		2	1		
Gdhendje të rrotave	1			1		1			

Tabela 4.3.3.2

S - Servisim,
R - Riparim,
K1 - Kontrollime njëmujor,
K3 - Kontrollime tremujor,
K6 - Kontrollime gjashtëmujor

IV.3.4 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të udhëtarëve të realizuar në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2024	2023	Ndryshimi
1.	Kontrollime K1	52	68	-16
2.	Riparim në punëtori	70	78	-8
3.	Gdhendje të rrotave	11	19	-8

Tabela 4.3.4

IV.3.5 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave të realizuara në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2024	2022	Ndryshimi
1.	Kontrollime K3	0	23	-23
2.	Riparim në punëtori	0	3	-3
3.	Gdhendje të rrotave	0	1	-1

Tabela 4.3.5

IV.3.6 Riparimi i vagonëve të huaj

Riparimi/mirëmbajtja e vagonëve të huaj	2024	2023
NewCo Ferronikeli	0.00 €	5,748.00€

Tabela 4.3.6

V. PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET

1. Gjendja financiare Janar – Dhjetor 2024
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (31.12.2024)
3. Transaksionet e realizuara (Janar – Dhjetor 2024)
4. Bilanci i Gjendjes (Janar – Dhjetor 2024)

V. 1. Gjendja financiare

Për periudhën raportuese Janar-Dhjetor 2024, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është siç vijon:

V.1.1. Të hyrat

Nga **Transporti i mallrave** kemi realizuar të hyrat prej 10,704.61€ për periudhën janar-dhjetor 2024. Totali i të hyrave të planifikuara për vitin 2024 është 1,150,000.00€ dhe nga kjo del se kemi realizuar 0.93% nga totali.

Të hyrat nga transporti i mallrave eksport/import janë realizuar sipas kategorive që pasojnë: të hyrat nga importi i kemi realizuar përmes vijës kufitare Hani i Elezit, të cilat janë në shumën prej 10,704.61€, ndërsa nga eksporti dhe transporti i brendshëm nuk kemi realizuar të hyra në këtë periudhë.

Transporti i udhëtarëve gjatë vitit 2024 është realizuar në shumën prej 1,670,909.22€. Nga të hyrat e faturuara nga Transporti i Kontraktuar janë 1,000,787.51€, nga të hyrat e planifikuara nga subvencionimi për mbulimin e pjesshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve kemi realizuar shumën prej 610,725.00€, ndërsa të hyrat nga biletat janë realizuar në shumën prej 59,396.71€. Shprehur në përqindje realizimi i të hyrave nga transporti i udhëtarëve është arritur në shkallën prej 84.67%, krahasuar me planifikimet e vitit 2024 – 1,973,275.00€.

Të hyrat nga shërbimet tjera gjatë vitit 2024, kanë arritur shumën prej 6,000.00€. Kjo shumë nëse krahasohet me shumën e buxhetuar për vitin 2024, e cila është 30,000.00€ arrin kuotën prej 20% të realizimit. Kjo e hyrë është realizuar nga kontrata me kompaninë GCF.

Të hyra tjera të cilat janë realizuar gjatë periudhës janar – dhjetor 2024, kanë arritur shumën prej 57,516.43€. Këto të hyra janë realizuar nga pozicionet si në vijim: Të hyrat nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh.A. – 25,214.79€, të hyrat nga qiraja në 27,966.10€, të hyrat nga kompanitë e sigurimeve në shumën prej 2,980.00€, të hyra tjera 371.97€ dhe të hyra nga llogaria e kursimeve FLEX në shumën prej 983.57€ Buxheti i planifikuar për këto të hyra ka qenë 20,000.00€, shprehur në përqindjen është realizuar 287.58% e planifikimit.

Të hyrat e realizuara gjatë kësaj periudhe janë jo të kënaqshme, arsyeja e mos realizimit të planifikuar është si pasojë e rregullimit të Linjës së Dhjetë Hekurudhore nga HK-Infrakos Sh.A., e cila ka ndikuar negativisht në realizimit e të hyrave për Transikos Sh.A.

V.1.2. Shpenzimet

Shpenzimet për periudhën janar–dhjetor 2024, ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara si në kategoritë që pasojnë:

Totali i kostos së shërbimit për vitin 2024 është 575,602.67€, ndërsa planifikimi ka qenë në shumën prej 1,227,500.00€, i cili është realizuar në shkallën prej 46.89%. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2024.

Shpenzimet e stafit janë kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur shumën prej 1,387,017.68€, dhe atë në paga dhe kontribute 1,386,144.18€, trajnime dhe shpenzime tjera në vlerë prej 873.50€. Në total, nëse krahasojmë shumën e buxhetuar prej 1,700,000.00€ për vitin 2024, kuota e realizimit është arritur në shkallën prej 81.59%.

Totali i shpenzimeve operative arrin shumën prej 10,144.32€, kjo shumë është vetëm 92.23% nga shuma prej 114,000.00€ e parashikuar vitin 2024. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2024.

Totali i shpenzimeve administrative ka arritur në kuotën prej 118.22%, konkretisht në shumën prej 118,815.32€. Planifikimi për vitin 2024, i kësaj kategorie është 100,500.00€. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2024.

V.1.3. Të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar – Dhjetor 2024


	EMËRTIMI	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Diferenca	B/C (%)	Realizimi 2023
	A	B	C	D	E	F
A	Shitjet					
1	Transporti i mallrave	1,150,000.00	10,704.61	1,139,295.39	0.93	466,594.48
2	TU – MMPHI	1,300,000.00	1,000,787.51	299,212.49	76.98	967,902.63
3	TU – Ministria e Ekonomisë	610,275.00	610,725.00	(450.00)	100.07	655,275.00
4	TU – Shitja e Biletave	63,000.00	59,396.71	3,603.29	94.28	61,356.49
5	Shërbimet tjera	20,000.00	6,000.00	14,000.00	30.00	6,063.56
6	Të ardhurat nga riparimi i vagonëve të huaj	10,000.00	-	10,000.00	-	5,748.00
7	Të hyrat tjera jo operative	20,000.00	57,516.43	(37,516.43)	287.58	25,672.83
I	TOTAL – TË HYRAT	3,173,275.00	1,745,130.26	1,428,144.74	54.99	2,188,612.99
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve					
1	Derivatet dhe lubrifikantet	772,000.00	316,541.40	455,458.60	41.00	415,518.71
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	30,000.00	20,716.37	9,283.63	69.05	29,433.26
3	Inventar dhe pajisje	5,000.00	696.53	4,303.47	13.93	279.32

4	Material harxhues	1,000.00	-	1,000.00	-	-
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	60,000.00	32,654.66	27,345.34	54.42	44,330.55
6	Qasja në binarë	320,000.00	174,251.73	145,748.27	54.45	209,967.51
7	Sigurimi i palëve të treta	5,000.00	1,692.00	3,308.00	33.84	-
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	10,000.00	-	10,000.00	-	1,841.25
9	KMSH Nafta Infrakos	20,000.00	25,388.98	(5,388.98)	126.94	25,559.10
10	Servisimi i arkave fiskale	4,500.00	3,661.00	839.00	81.36	2,362.71
12	Zbritjet e lejuara	-	-	-	-	-
	TOTAL – KOSTOJA E SHËRBIMIT	1,227,500.00	575,602.67	651,897.33	46.89	729,292.41
	Fitimi (humbja) bruto	1,945,775.00	1,169,527.59	776,247.41	60.11	1,459,320.58
	TË ARDHURAT TJERA					
1	Të ardhurat e jashtëzakonshme	-	-	-	-	-
2	Të hyrat subvencione (shpenzimet)	-	6266.94	(3,422.80)	-	-
3	Të hyrat nga shitja e skrapit (shitja e aseteve)	-	-	-	-	-
4	Të ardhura tjera (shitja e skrapit-mbeturinat)	-	-	-	-	3,536.86
	TOTAL – Të ardhurat tjera	-	6266.94	(3,422.80)	-	3,536.86
C	Shpenzimet e stafit					
1	Pagat dhe kontributet	1,695,000.00	1,386,144.18	308,855.82	81.78	1,528,308.07
2	Sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera	5,000.00	873.50	4,126.50	17.47	856.00
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	1,700,000.00	1,387,017.68	312,982.32	81.59	1,529,164.07
D	Shpenzimet operative					
1	Mirëmbajtje dhe riparime	10,000.00	5,600.15	4,399.85	56.00	3,514.47
2	Shpenzimet logjistike	12,000.00	20,480.40	(8,480.40)	170.67	11,189.03
3	Energjia elektrike dhe komunali	7,000.00	173.56	6,826.44	2.48	4,496.60
4	Kontrollimet sistematike	2,500.00	2,350.00	150.00	94.00	1,350.00
5	Marketingu	10,000.00	926.80	9,073.20	9.27	2,588.66
6	Udhëtimet zyrtare	1,000.00	535.83	464.17	53.58	-
7	Telefonat dhe Posta	20,000.00	8,761.04	11,238.96	43.81	11,193.58
8	Shërbimet bankare	1,500.00	638.62	861.38	42.57	677.22
9	Tatimet	40,000.00	64,097.48	(22,600.82)	156.50	70,984.48
10	Pajisje elektronike	10,000.00	1,580.44	8,419.56	15.80	2,627.71
11	Shpenzimet e interesit të kredisë	-	-	-	-	6,089.41
	TOTAL - Shpenzimet operative	114,000.00	105114.32	10,352.34	90.92	114,711.16
E	Shpenzimet administrative					

1	Inventar dhe pajisje	5,000.00	54.41	4,945.59	1.09	1,557.15
2	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	15,000.00	5,814.68	9,185.32	38.76	1,224.56
3	Material i zyrës	20,500.00	7,188.64	13,311.36	35.07	8,375.88
4	Material sanitar	7,000.00	1,443.65	5,556.35	20.62	1,714.06
5	Qiraja për objektet	15,000.00	7,388.54	7,611.46	49.26	13,727.00
6	Reprezentacioni dhe bufeja	4,000.00	2,906.07	1,093.93	72.65	2,650.06
7	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	4,000.00	90,481.62	(86,481.62)	2,262.04	702.45
8	Shpenzimet logjistike	20,000.00	3,537.71	16,462.29	17.69	7,844.95
9	Kontingjente	10,000.00	-	10,000.00	-	469.49
	TOTAL - shpenzimet administrative	100,500.00	118,815.32	(18,315.32)	118.22	38,265.60
	Provizionimi i llogarive të arkëtueshme	-	-	-	-	3,553.20
II	TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)	3,142,000.00	2,186,579.99	956,916.67	69.54	2,414,986.44
III	Fitimi (Humbja) para zhvlerësimit	31,275.00	(435,182.79)	467,805.27	(1,395.78)	(222,836.59)
	GRANTET	102,500.00	309,976.14	(207,476.14)	302.42	368,524.68
F	Shpenzimet e zhvlerësimit					
1	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve	102,500.00	309,976.14	(207,476.14)	302.42	368,524.68
2	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë	3,750.00	53,447.03	(49,697.03)	1,425.25	50,128.03
	TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit	106,250.00	363,423.17	(257,173.17)	342.05	418,652.71
G	Fitimi (humbja) nga veprimtaria	27,525.00	(488,629.82)	517,502.30	(1,780.12)	(272,964.62)


Tabela 5.1

Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit për vitin 2024



Diagrami 5.1

Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive për vitin 2024



Diagrami 5.2

V. 2. Gjendja në para të gatshme – raporti sipas bankës (31.12.2024)

Nr.	EMËRTIMI	Saldo 31-12-2024
1.	PCB nr. 1114-004229-0001-59	1,172.54
2.	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	0.00
3.	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	0.86
4.	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	3.90
5.	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	0.48
6.	GH-PCB nr. 1114004229040114	27.52
7.	Llogaria Kursimeve – FLEX – 1114-0042-2900-0165	526,109.79
	TOTALI	527,315.79

Tabela 5.2

V.3. Transaksionet e realizuara (Janar – Dhjetor 2024)

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e Ndërmarrjes në llogaritë rrjedhëse dhe ato në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës dhe llogaritë rrjedhëse për subvencione:

Transaksionet në llogaritë rrjedhëse (€)	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2024	358,104.90
Inkasimet e pranuar gjatë muajve janar– dhjetor 2024	1,179,778.19
Pagesat e kryera gjatë muajve janar– dhjetor 2024	1,536,710.55
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2024	1,172.54

Tabela 5.3

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës (€)	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2024	0.37
Inkasimet e pranura gjatë muajve janar – dhjetor 2024	729,840.86
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2024	729,840.37
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2024	0.86

Tabela 5.4

Transaksionet e kompanisë nga subvencionet (MMPHI dhe ME) në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2024	163,555.38
Inkasimet e pranura gjatë muajve janar – dhjetor 2024	1,974,684.88
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2024	2,138,235.88
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2024	4.38

Tabela 5.5

Transaksionet e kompanisë Llogaria e kursimeve FLEX në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.10.2024	0.00
Inkasimet e pranura gjatë muajve janar - dhjetor 2024	1,684,504.00
Pagesat e kryera gjatë muajve janar - dhjetor 2024	1,158,394.21
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2024	526,109.79

Tabela 5.6

Në tabelën më poshtë janë paraqitur transaksionet më të mëdha gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024 për deponimet dhe pagesat:

Deponimet Janar-Dhjetor 2024			Pagesat Janar-Dhjetor 2024		
1	Deponime nga MMPHI	1,096,959.68	1	Pagat e punëtorëve	1,176,437.38
2	Deponime nga Ministria e Ekonomisë	610,721.20	2	Pagesa e derivateve	413,151.81
3	Deponime nga NewCo Ferronikeli	392,634.08	3	Pagesë për ATK	208,933.59
4	Deponime nga BK për Investime Kapitale	411,516.36	4	Pagesë për Infrakos Sh.A	236,258.30
5	Deponime nga transporti i udhëtarëve	65,467.93	5	Pagesë për Investime kapitale	411,516.36
TOTALI		2,577,299.25	TOTALI		2,446,297.44

Tabela 5.7

V.4. Bilanci i gjendjes (Janar – Dhjetor 2024)

BILANCI I GJENDJES NË €		
NP TRAINKOS SH.A.	GJENDJA FILLESTARE 01.01.2024	GJENDJA PERFUNDIMTARE 31.12.2024
Mjetet themelore - vlera neto sipas librave	2,088,085.07	2,242,734.25
Mjetet Qarkulluese	1,402,147.39	1,012,659.07
Stoqet	412,828.61	420,534.77
Paraja	522,806.17	528,003.52
Llogarite e arkëtueshme	443,537.80	51,179.71
Kërkesa tjera të arkëtushme	6,549.72	0.00
Parapagimet	16,425.09	12,766.07
Total Mjetet Qarkulluese dhe themelore	3,490,232.46	3,255,393.32
Detyrimet afatshkurta	1,961,180.08	2,117,841.31
Llogaritë e pagueshme	640,200.53	754,837.32
Të pagueshme tjera - detyrime	874,84	558.44
Detyrime tatimore	955,141.71	997,482.55
Detyrimet e kredisë	364,963.00	364,963.00
Detyrimet afatgjata	1,459,423.18	1,554,696.31
Kapitali	5,292,179.92	5,294,036.28
Fitimi/Humbja e bartur	-4,949,586.10	-5,222,550.72
Fitim/ Humbja e vitit	-272,964.62	-488,629.86
Total detyrimet dhe kapitali	3,490,232.46	3,255,393.32

Tabela 5.8

VI. PROJEKTET KAPITALE

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të gjitha projektet/kontratat për vitin 2024, të financuara nga Buxheti Operativ i Trainkos Sh.A. dhe Buxheti i Kosovës.

Nr	Titulli i Aktivitetit të Prokurimit	Data e nënshkrimit	Vlera e parashikuar	Vlera e kontratës	Koment
1	Riparimi i PG Rregullatorit të lokomotivës GT22HW-2 (645)	Janar	9,000.00	8,810.00	Përfunduar
2	Shërbimet e abonimit të arkave fiskale	Shkurt	4,319.98	4,319.98	Në zbatim
3	Shërbimet e Auditimit të pasqyrave Financiare për vitin 2023, 2024, 2025	Dhjetor 2023	9,500.00	7,839.97	Në zbatim
4	Furnizimi me material hixhienik	Mars	2,599.00	1,433.63	Përfunduar
5	Furnizimi me vajra dhe lubrifikante	Mars	30,000.00	3.16	Në zbatim
6	Riparimi i pajisjeve dhe mjeteve lëvizëse hekurudhore	Nëntor 2023	130,000.00	129,497.72	Përfunduar
7	Shërbimet e sigurimit të palëve të treta	Prill	2,000.00	1,996.56	Në zbatim
8	Furnizimi me modul kontrole për diesel motor të tipit 8-710G3B-2	Qershor	10,000.00	7,080.00	Dështuar
9	Riparimi i mesëm i vagonëve të transportit të udhëtarëve	Maj	423,100.02	423,100.02	Në zbatim
10	Shërbimet e atestimit dhe mirëmbajtjes së vincit 10t	Prill	6,500.00	1,700.00	Përfunduar
11	Furnizimi me pjesë rezervë për mirëmbajtjen e MML (sensor te shpejtesisë)	Maj	2,500.00	1,722.80	Në zbatim
12	Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezervë për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse (Furnizim me filtra për lokomotiva)	Shtator	16,000.00	15,147.36	Në zbatim
13	Kontrollet sistematike shëndetësore të punëtorëve të Trainkos Sh.A.	Korrik	9,500.00	9,500.00	Në zbatim
14	Furnizimi me thika dhe pjesë rezervë për torno	Shtator	3,500.00	1,699.20	Përfunduar
15	Riparimi i pjesëve dhe pajisjeve te MML (Riparimi i modulit të kahjes, pllakës elektronike, modulit të	Shtator	3,000.00	2,873.01	Përfunduar

	kontrollit dhe gjeneratorit të nxemjes)				
16	Furnizim me pajisje dhe pjesë rezervë për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse (furnizim me papuçe frenuese për lokomotiva)	Nëntor	15 000,00	14 438,48	Përfunduar
17	Furnizimi me brusha për lokomotiva JT38CW dhe 661	Dhjetor	5 660.00	3 858,60	Në zbatim
18	Mirëmbajtja e sistemit financiar PLANET ACCOUNTING	Janar	11.800	10.800.12	Në zbatim

Tabela 7.1

1. Riparimi i PG Rregullatorit të lokomotivës GT22HW-2 (645). Është projekt i tenderuar i cili është paraparë të financohet përmes mjeteve të dedikuara për projekte kapitale. Projekti ka përfunduar sipas kërkesave të njësisë kërkuese.

2. Shërbimet e abonimit të arkave fiskale. Është projekt i cili është kontraktuar dhe është në zbatim.

3. Shërbimet e Auditimit të pasqyrave Financiare për vitin 2023, 2024, 2025. Është kontraktuar me vlerë të ofertës prej **7,839.97€**. Projekti është kontraktuar për periudhën trevjeçare dhe është në zbatim e sipër.

4. Furnizimi me material hixhienik. Është projekt i cili ka përfunduar.

5. Furnizimi me vajra dhe lubrifikante. Është projekt i cili është tenderuar në bazë të sasive të kërkuara nga njësia kërkuese. Kontrata është lidhur me çmime njësi e cila do të përfundon me realizimin e buxhetit të alokuar prej 30,000.00€ sikurse në deklaratën e nevojave dhe disponueshmerisë së fondeve.

6. Riparimi i pajisjeve dhe mjeteve lëvizëse hekurudhore – Ndërrimi i rrotave në karretat e lokomotivës. Në përputhje me marrëveshjen për projekte kapitale e kemi ritenderuar. Projekti është kontraktuar dhe është pranuar edhe nga komisioni i pranimit teknik. Vlen të theksohet se projekti ka përfunduar me vonesa dhe se në përfundim janë aplikuar dënimet prej 10% të totalit të kontratës në përputhje me kushtet e kontratës.

7. Shërbimet e sigurimit të palëve të treta. Shërbimet janë kontraktuar dhe projekti është në zbatim.

8. Projekti për furnizim me pajisje dhe pjesë rezervë për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse. Për këtë projekt është vlerësuar se vetëm **LOT 3. Furnizimi me modul kontrolle për diesel motor të tipit 8-710G3B-2** ka oferta të përgjegjshme. Projekti është kontraktuar dhe është në zbatim.

9. Riparimi i mesëm i vagonëve të transportit të udhëtareve. Është tenderuar sipas kërkesave të njësisë kërkuese. Kemi pranuar vetëm një ofertë të cilën komisioni i vlerësimit e ka rekomanduar për kontratë. Për shkak të tejkalimit të buxhetit për 9 %, në përputhje me

LPP-në dhe RRPP kemi kërkuar nga njësia kërkuese që të vendosin mbi tejkalimin e buxhetit, të cilët e kanë konfirmuar se do të shtojnë buxhetin. Projekti është në implementim.

10. Riparimi i pjesëve dhe pajisjeve të mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse. Është projekt i cili është i ndarë në tri pjesë (LOT) dhe është i buxhetuar në Buxhetin e Kosovës. Për këtë projekt kemi pranuar dy oferta, të cilat janë për LOT 3, derisa dy LOT-et tjera kanë dështuar. Shërbimet për atestimin e vinçit kanë përfunduar dhe janë pranuar nga komisioni i pranimit. Janë dorëzuar të gjitha dokumentet bashkë me faturën në ME për transferim të mjeteve sipas Marrëveshjes.

11. Furnizimi me pjesë rezervë për mirëmbajtjen e MML (senzor shpejtësisë). Është projekt i cili është tenderuar dhe kemi pranuar oferta. Komisioni ka vlerësuar se ka oferta të përgjegjshme dhe ka rekomanduar dhënien e kontratës. Kontrata është nënshkruar dhe është në zbatim e sipër. Janë dërguar të gjitha dokumentet te zyra e auditimit që të bëjë auditimin në përputhje me marrëveshjen për projekte kapitale me ME.

12. Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezervë për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse (Furnizim me filtra për lokomotiva). Është projekt që ka dështuar disa herë në mungesë të ofertave të përgjegjshme. Projekti është kontraktuar dhe i njëjti është në zbatim e sipër.

13. Kontrollat sistematike shëndetësore të punëtorëve të Trainkos Sh.A. Është projekt i cili është tenderuar dhe është pranuar një ofertë, e cila është nga IMB (Instituti i Mjekësisë së Punës) në Obiliq. Projekti është kontraktuar dhe është në zbatim e sipër.

14. Furnizimi me thika dhe pjesë rezervë për torno. Furnizimi me thika dhe pjesë rezervë për torno është projekt i cili është i përsëritur. Projekti ka pranuar oferta të mjaftueshme dhe është shpallur fituesi. Liferimi i mallrave është kryer dhe jemi në procedurë të përgatitjes për ta dërguar në ME për transferim të mjeteve të BK.

15. Projekti Riparimi i pjesëve dhe pajisjeve të MML (Riparimi i modulit të kahjes, pllakës elektronike, modulit të kontrollit dhe gjeneratorit të nxemjes) është vlerësuar nga komisioni dhe është konstatuar se oferta është e përgjegjshme. Projekti ka përfunduar me sukses dhe i njëjti është në përgatitje të dokumenteve që të dërgohet për transferim të mjeteve në ME.

16. Furnizim me pajisje dhe pjesë rezervë për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse (furnizim me papuçe frenuese për lokomotiva). Është projekt i cili është nënshkruar kontrata dhe është në përfundim.

17. Furnizimi me brusha për lokomotiva JT38CW dhe 661. Është projekt i cili është nënshkruar kontrata dhe është në zbatim e sipër.

18. Mirëmbajtja e sistemit financiar PLANET ACCOUNTING - Kontrata është nënshkruar në janar të vitit 2024 dhe është në fazën e implementimit. Ajo ka një afat prej 3 vitesh (36 muaj).

VII. AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT

VII.1. Planifikimi dhe Zhvillimi i Biznesit

Gjatë vitit 2024, Trainkos është përballur me mosrealizimin e të hyrave nga transporti i mallrave, sidomos për shkak të ngecjeve në operacionet e NewCo Ferronikeli dhe problemeve të saja të brendshme, e cila nuk ka filluar transportin vendor siç ishte planifikuar sipas deklaratimit zyrtar fillestar. Vonesat në modernizimin e Linjës së 10-të hekurudhore kanë ndikuar negativisht në transportin hekurudhor ndërkombëtar, duke çuar klientët në përdorimin e alternativave përmes transportit rrugor. Përkundër disa kërkesave, transporti hekurudhor ndërkombëtar nuk ka mund të realizohet. Vlen të përmendet se prej muajit dhjetor 2024 NewCo Ferronikeli në takimin e mbajtur me Ndërmarrjen ka kërkuar mundësi transporti ndërkombëtar për sasi të mëdha të xehes përmes portit të Selanikut, mirëpo planifikimi dhe kontraktimi i transportit ka qenë i pamundur për shkak të mos funksionimit të linjës hekurudhore Fushë Kosovë – Hani i Elezit.

Transporti i pasagjerëve karakterizohet me vazhdimin e zbatimit të Marrëveshjes bazë për OShP 2023 – 2027. Vonesat në projektin e modernizimit të linjës Fushë Kosovë – Hani i Elezit kanë kufizuar operacionet e pasagjerëve në vetëm katër trena në linjën Prishtinë – Pejë.

Ndërmarrja duhet të koordinojë planet strategjike shtetërore dhe të sigurojë burime financiare për të realizuar objektivat e saj. Finalizimi i legjislacionit për transportin hekurudhor dhe zbatimi i praktikave më të mira mbeten prioritet për përafrimin me standardet e BE-së dhe krijimin e një zone të vetme evropiane të transportit hekurudhor.

Modernizimi dhe lëshimi në shfrytëzim i linjave hekurudhore dhe ndërmarrja e masave shtetërore për bartjen e potencialit transportues nga rruga në hekurudhë duhet të mbetet imperativ për zbatimin e praktikave më të mira si dhe finalizimi dhe zbatimi i legjislacionit adekuat për transportin hekurudhorë në Republikën e Kosovës.

Ndërmarrja vazhdon të përballlet me mungesën e flotës së mjeteve lëvizëse për transportin e mallrave dhe udhëtarëve, pa një përgjigje të qartë mbi pasurimin e flotës. Flota aktuale është e pamjaftueshme për nevojat ekzistuese dhe të ardhshme, ndërsa mungesa e stafit teknik të trajnuar përbën një sfidë shtesë.

Për të garantuar zhvillimin dhe sigurinë në transportin hekurudhor, nevojitet investim në modernizimin dhe mirëmbajtjen e flotës, si dhe anëtarësimi në asociacione ndërkombëtare. Pa këto masa ndërmarrja mbetet e kufizuar në konkurrencën rajonale dhe integrimin në rrjetin evropian të transportit.

Për më tepër, mungesa e mjeteve lëvizëse adekuate dhe buxheti i pamjaftueshëm kanë penguar zhvillimin e shërbimeve të transportit hekurudhor. Strategjia e Transportit Multimodal 2023 – 2030 kërkon modernizimin e flotës dhe përshtatjen me standardet evropiane (ERTMS), por deri më tani, asnjë progres i prekshëm nuk është bërë në këtë drejtim.

Në periudhën raportuese, Ndërmarrja ka shqyrtuar mundësi bashkëpunimi ndërkombëtar me institucione të ndryshme por sfidat institucionale dhe mungesa e mbështetjes financiare kanë frenuar avancimin e projekteve.

Ndër prioritetet mbeten:

- Përfundimi i projektit të modernizimit të linjës hekurudhore;
- Investimi në flotën e mjeteve lëvizëse;
- Mbështetja institucionale për zhvillimin e transportit hekurudhor si pjesë e Planit Zhvillimor Kombëtar 2023 – 2030;
- Përfshirja e Trainkos në planet investive të Qeverisë për të siguruar qëndrueshmërinë dhe rritjen e kapaciteteve transportuese;
- Në mungesë të zgjidhjeve konkrete, Ndërmarrja përballet me sfida të rënda që rrezikojnë operimin dhe mbijetesën në tregun e transportit.

Pjesëmarrja e Trainkos-it në iniciativat e BE-së për reforma në transportin hekurudhor përmes Lëvizshmërisë së Qëndrueshme

Pjesëmarrja dhe përcjellja e aktiviteteve që ndërmerr Bashkësia Evropiane përmes DG MOVE në iniciativat për Lëvizshmëri të Qëndrueshme gjatë viti 2024 ka qenë e ngjeshur, kjo kryesisht për veprimet e mëposhtme që në realitet janë edhe finalizimi i proceseve vjetore të parapara sipas planit të veprimit në sektorin hekurudhor:

1. Ligji i ri për Hekurudhat dhe Ligji për Siguri dhe Ndërveprueshmëri janë në proces të formulimit përmes grupeve punuese adekuate të caktuara nga Ministri i MMPHI-së. Përkundër vonesave janë definuar afatet për të përfunduar secili proces në kohën optimale. Më këtë do të plotësohen kriteret e funksionimit modern të transportit hekurudhor dhe kompletimi i dokumentacionit bazë që trason vazhdimin e reformave në legjislacionin që rregullon transportin modern me hekurudhë. Vonesat kanë ndodhur edhe përkundër parashikimit që të përfundohen draftet brenda vitit 2024, obligimi në realizimin e kësaj detyre mbetet për vitin 2025;
2. Sipas kërkesave për reforma nga BE dhe planit legjislativ të MMPHI-së është finalizuar / aprovuar Strategjia e Sistemit Inteligjent për Transport (SIT) 2024 – 2030 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë SIT 2024 – 2026 dhe
3. Më 12 Dhjetorë 2023 në takimin e Shkupit të Sekretariatit për zbatimin e Traktatit për Transport është aprovuar kërkesa e Kosovës për përfshirjen në Rrjetin Bazik Hekurudhor të Evropës të projektit për Shatëll Trenin që lidhë kryeqytetin me aeroportin (Prishtinë – Aeroport – Prishtinë). Mundësitë për realizim të shpejtë të projektit qëndrojnë, por pamundësia e realizimit të projekteve që mbështeten nga BE për shkak të sanksioneve ka stopuar këtë proces. Në tërë këtë proces Trainkos-i duhet të mbetet syçelë për përgatitjet e domosdoshme sipas praktikave dhe legjislacionit të ri për mundësitë dhe format e furnizimit me mjete lëvizëse dhe rekrutimit dhe përgatitjes së stafit adekuat.

VII.2. Koordinimi i proceseve me MMPHI, ARH-në dhe Institucionet tjera relevante

Edhe në periudhën raportuese për vitin 2024 kanë vazhduar angazhimet në plotësimin e obligimeve në raport me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Sekretariatit për zbatimin e Traktatit për Transport, Autoritetin Rregullativ të

Hekurudhave (ARH), Ministrinë e Ekonomisë (ME), Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA). Ndër aktivitetet më të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë periudhës raportuese vlen të veçohen:

- Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe mbështetja në fushatën globale “16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore”;
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës dhe mbështetja e ekspozitës së mbajtur nën patronatin e Ministrisë së Kulturës, në kuadër të 25-vjetorit të çlirimit vendit;
- Bashkëpunimi me Qendrën për Zhvillimin e Artit, është mbështet ngjarja ndërkombëtare “Int.Meeting of Styles” 2024 në Prishtinë, ju është dhënë në shfrytëzim një vagon udhëtarësh nga data 27 qershor deri me 1 korrik 2024;
- Angazhim përmes përfaqësimit për hartimin e Ligjit të ri për Hekurudhat dhe Ligjit për Siguri dhe Ndërveprueshmëri;
- Është organizuar dhe realizuar vizita e rregullt vjetore e përgjegjësve të ARH-së për gjendjen dhe kënaqshmërinë e udhëtarëve gjatë udhëtimit me tren;
- Janë përgatitur dhe dorëzuar raportet e rregullta mujore për statistikën e transportit të realizuar nga Trainkos-i në ARH;
- Është punuar me ARH-në në finalizimin e procesit të çregjistrimit të mjeteve lëvizëse të shitura si skrap;
- I janë dërguar në baza mujore ARH-së statistikën e transportit të realizuar për mallra dhe udhëtarë;
- Janë kompletuar të dhënat (statistikën në baza mujore) sipas kërkesës së ASK-së dhe obligimeve ligjore për statistika në baza mujore;
- Me përgjegjësit e ARH-së është punuar në procesin e identifikimit dhe konfirmimit të licencave të makinistëve sipas kategorive dhe gjendjes momentale me proceset që po kalon Ndërmarrja;
- Komunikimi dhe plotësimi i obligimeve që rrjedhin nga Marrëveshja për huazimin e Lokomotivës Ambasadore muzeut të hekurudhave në Augsburg ka rezultuar në plotësimin e kërkesave nga ana e jonë, mbetet të përfundojnë proceset e transportit të lokomotivës deri në destinacionin final nga huamarrësi dhe
- Është organizuar dhe punuar raporti vjetor (2024) i inspektimit të mjeteve lëvizëse nga ARH.

VII.3. Aktivitet e Marketingut

Spektori i Marketingut funksionon në kuadër të Departamentit të Zhvillimit të Biznesit të Trainkos Sh.A. dhe merret kryesisht me përpilimin e kontratave të transportit, përpunimin e analizës së buxhetit të të hyrave për klientë, mbajmë kontakte dhe realizojmë vizita të vazhdueshme me klientët e rregullt, prezantojmë shërbimet e Trainkos Sh.A. duke realizuar vizita drejt klientëve potencialë, pranimin e kërkesave të transportit, procedimin e kërkesave drejt të gjithë partnerëve tanë vendorë dhe ndërkombëtarë si dhe procedimin e ofertave drejt të gjithë klientëve.

Përveç aktiviteteve të sipërpërmendura, Sektori i Marketingut kryen edhe aktivitete të tjera në fushën promovuese dhe menaxhon buxhetin e shpenzimeve të Sektorit të Marketingut për promovimin e shërbimeve të Trainkos Sh.A. përmes kanaleve të ndryshme të marketingut.

Sektori i marketingut në vitin 2023 ka menaxhuar me rreth 15,600.00€buxhet të shpenzimeve në nivel të shitjeve tek të cilat kemi planifikuar të hyra rreth 1,450.000.00€, që nënkupton se shpenzimet e marketingut kanë marrë pjesë me vetëm 1.07 % në totalin e të hyrave të realizuara. Sektori i Marketingut paraprakisht harton planin vjetor të sektorit të marketingut për t'i parashtruar objektivat dhe strategjitë që do t'i zhvillojë gjatë vitit 2024 krahas aktiviteteve në fushën e përditshme – rutinore si dhe atë propaganduese – mediave që zhvillohen në këtë sektor bazuar në Planin e Biznesit të Trainkos Sh.A.

Krahasuar me vitin paraprak sektori i marketingut në vitin 2024 ka në dispozicion 9,000.00€buxhet të shpenzimeve për nevoja të promovimit të shërbimeve të Trainkos Sh.A që nënkupton se ka 40% të mjeteve të disponueshme më pak se në vitin paraprak ku sipas të hyrave nga shitjet e parapara me rishikimin e planit të biznesit në nivel të kompanisë parashihen të jenë rreth 1,150,000.00€përgjatë vitit 2024 që nënkupton se shpenzimet e marketingut kanë marrë pjesë me vetëm 0.79 % në totalin e të hyrave të planifikuara.

Nga klientët vendorë, me të cilët kemi pasur të nënshkruar aneks kontratë për transport deri më 31.12.2023 ka qenë vetëm një, klienti nuk ka vazhduar kontratën gjatë vitit 2024:

Nr.	Emri i kompanisë	Emri dhe Mbiemri	Përfaqësuesi	Vendi	Mallrat që transporton
1.	NewCo Ferronikeli	Cemil	Acar	Drenas	Xehe të nikelit dhe thëngjill.

*Klientët/Partnerët ndërkombëtarë të cilët kanë nënshkruar kontratë transporti me Trainkos Sh.A. për vitin 2024 janë gjithsej tre (3) të njëjtit kanë pasur kontratë të nënshkruar edhe në vitin 2023, përjashtimisht klienti/partneri **Schenker DB** dhe **Fershpel AD**.*

Më poshtë prezantojmë listën e partnerëve ndërkombëtarë:

Nr.	Emri i kompanisë	Emri dhe Mbiemri	Përfaqësuesi	Vendi	Mallrat që transporton
1.	NAVICO SHIPPING DOO	Zlatko Crvenkoski	Stefan Stefanovski	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
2.	CARGO LOGISTC DOO	Zoran Bakraceski	Marjan Veleviski	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
3.	ARGO LOGISTIC INT	Viktor Tatabitovski	Viktor Tatabitovski	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet

*Klienti/partneri **Shcenker DB** nuk e ka nënshkruar kontratën për vitin 2024 për shkak të pamundësisë së transportit të mallrave për arsye të mbylljes së linjës hekurudhore Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Hani i Elezit. Ndërsa klienti **Fershpel AD** nuk ka paguar garancionin bankar për shkak se nuk ka informatë të saktë për hapjen e linjës Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Hani i Elezit nga Infracos Sh.A dhe kontrata e tij sipas Rregullores së TM-së nuk është e vlefshme deri në pagesën e garancionit. Fershpel AD*

ka pranuar që pagesat e transportit t'i realizoj në avancë në rast se do të këtë ndonjë transport gjatë vitit 2024.

Në bazë të të dhënave të prezantuara më lart, Sektori i Marketingut gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024 është angazhuar për të realizuar aktivitetet e parapara në Planin Vjetor të Sektorit të Marketingut dhe po ashtu objektivat e përcaktuara nga Plani i Biznesit për vitin 2024.

Sektori i Marketingut ka realizuar kryesisht aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me përpilimin e kontratave të transportit, përpunimin e analizës së buxhetit të të hyrave për klientët e rregullt, janë mbajtur kontakte me klientë dhe me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, janë pranuar kërkesa për shfrytëzimin e aseteve të Trainkos Sh.A. kryesisht për qëllime të xhirimeve (të natyrave të ndryshme), të cilat pas aprovimit janë proceduar më tutje. Po ashtu janë përgatitur edhe oferta konkrete të udhëtimit me tren për Transport të Udhëtarëve.

Ndërsa sa i përket pjesëmarrjes tonë në fushën promovuese, ne nuk kemi qenë prezent në shumë kanale të marketingut për shkak të kostove shumë të larta dhe kemi shpenzuar në mënyrë sa më optimale të mundshme pasi që edhe kërkesa e DBZH-së ka qenë që të gjitha shpenzimet e Sektorit të Marketingut të minimizohen për shkak të gjendjes financiare jo të mirë në nivel të kompanisë.

Përparësi në këtë drejtim, në fushën e promovimit të shërbimeve kemi bërë në promovimin e aplikacionit “Orari i Trenave” të krijuar nga persona me nevoja të veçanta për Trainkos Sh.A., ku kjo kategori ka mundësi dëgjimi të Orarit të Lëvizjes së Trenit dhe arritjen e trenit në çdo stacion në Relacionet: Prishtinë – Pejë – Prishtinë dhe Prishtinë – Shkup – Prishtinë.

Po ashtu rendësi të veçantë i kemi dhënë reklamimit në Monitorët e vendosur në vagonët e udhëtarëve, ku bëhet njoftimi i drejtpërdrejt për Orarin e Lëvizjes së Trenit, promovimi i shërbimeve dhe dizajneve të ndryshme të krijuar nga zyra e Marketingut.

VII.4. Shqyrtimi i mundësive për kryerjen e veprimtarive tjera sipas licencës që ka Trainkos-i

Edhe në vitin 2024 nga situata e krijuar Trainkos Sh.A. mbetet pa zhvilluar aktivitetin e saj minimal ashtu si nevojat krijohen dhe sektori hekurudhor zhvillohet. Trainkos-i me Certifikatë të regjistrimit të biznesit ka të drejtë që përveç transportit të mallrave dhe udhëtarëve me hekurudhë të ofrojë edhe shërbime tjera siç janë: Transport tjetër i rregullt tokësor i udhëtarëve, konstruktim dhe riparim të mjeteve lëvizëse hekurudhore, transport tokësor rrugor i udhëtarëve, transporti rrugor i mallrave, transporti detar dhe bregdetar, transport në rrugët e brendshme, ngarkim – shkarkim i peshave, magazinim i mallit, veprimtaritë tjera përcjellëse të transporti tokësor dhe veprimtari e agjencive të tjera të transportit. Me këtë mundësi Ndërmarrja duhet t'i paraprinë proceseve që janë parashikuar me Strategjitë shtetërore për transportin, konkretisht për transportin e mallrave edhe udhëtarëve edhe me hekurudhë. Në këto aktivitete hyn edhe veprimtaria e shpedicionit ku që nga ndarja e Hekurudhave të Kosovës (viti 2011) ka mbetur në fazën e përgatitjes së proceseve fillestare të zhvillimit të kësaj veprimtarie! Duhet të kemi parasysh se në fazën kur do të rifillojë dhe evoluojë transporti i mallrave përfshirja e kësaj veprimtarie në shërbimet që ofron Trainkos-i do të mundësonte një qasje më të kompletuar në raport me

klientët ekzistues dhe klientët e ri potencialë në të ardhmen për transportin e mallrave. Për këtë dhe hapat tjerë të domosdoshëm ngecja pengon mundësinë e të qenit të gatshëm me fillimin e zhvillimit të domosdoshëm dhe humbjen e hapit me konkurrencën.

VII.5. Sfidat kryesore gjatë vitit 2024 dhe veprimet për të ardhmen

Gjatë periudhës raportuese, si kompani vazhdojmë të ballafaqohemi me sfidat si në vijim:

1. Ballafaqimi në vazhdimësi me ndërprerje të linjës Fushë Kosovë – Hani i Elezit gjatë Modernizimit të këtij sesioni. Vonesat në realizimin e projektit “Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore” si infrastrukturë bazë që bën lidhjen me pjesën tjetër të Evropës dhe porte detare;
2. Gjendja jo e mirë e mjeteve lëvizëse për shkak të vjetërisë së tyre dhe nevoja për mjete lëvizëse adekuate për plotësimin e kërkesave për transportin e mallrave dhe udhëtarëve;
3. Restriksionet e vendosura nga Maqedonia Veriore për transport të minimum 6 vagonëve që vijnë në drejtim të Kosovës;
4. Mungesa e ligjit për sigurinë në komunikacionin hekurudhor;
5. Nevojitet ndryshimi/amendamenti i Ligjit për Hekurudhat;
6. Proceset e shumta gjyqësore të trashëguara nga ish-Hekurudhat e Kosovës;
7. Mos funksionimi i të gjitha linjave hekurudhore;
8. Mos zbatimi i bazës ligjore dhe mungesa e legjislacionit sekondar në sektorin e transportit dhe lejimi i konkurrencës jolojale;
9. Licencimi dhe futja në treg e operatorit hekurudhor privat, pa ndonjë analizë të mirëfilltë të tregut nga ana e institucioneve relevante dhe rreziku i regjistrimit të pretendentëve tjerë;
10. Neglizhenca e institucioneve relevante të cilat veprojnë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës në inkorporimin e operatorit shtetëror në planifikimet strategjike për zhvillim industrial të vendit;
11. Moshë mesatare e lartë e personelit ekzekutiv, nevoja për staf të kualifikuar që mund të përcjell trendin e zhvillimit të reformave/zhvillimeve në sektor.

Duke pasur parasysh që sfidat e lartcekura janë të natyrave të ndryshme dhe kërkojnë përkrahje edhe nga shumë institucione relevante, ndërmarrja është munduar në vazhdimësi që këto sfida/probleme t'i paraqes dhe të kërkojë zgjidhje/mbështetje. Por, ka qenë e pamundur arritja e rezultateve pozitive duke rezultuar edhe me mos përmirësimin e përgjithshëm të Ndërmarrjes.


Përkushtimi mbetet dhe do të insistojmë që të gjitha këto probleme të trajtohen nga institucionet dhe faktorët tjerë relevantë në mënyrë që të marrim zgjidhjet e duhura, me qëllim të zhvillimit të Ndërmarrjes si aset shtetëror.

Për këto sfida të precizuara më lart përgjegjësit në kompaninë Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. sipas planifikimeve mbesin të përkushtuar në angazhimin maksimal në realizimin e objektivave të parashtruara dhe tregojmë përkushtimin në angazhimet tona për të avancuar format e planifikimit në periudhat që na presin sipas ndryshimeve/planifikimeve shtetërore për transportin me hekurudhë.

VIII. STRUKTURA ORGANIZATIVE

Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në HK - Trainkos SH.A është si vijon:

Skema Organizative:



Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të HK-Trainkos Sh.A. më 01 Janar 2024 dhe më 31 Dhjetor 2024				
Totali i të punësuarve	01.01.2024		31.12.2024	
	193		173	
Vlerat	Vlerat në numra		Vlerat në përqindje	
Datat	01.01.2024	31.12.2024	01.01.2024	30.12.2024
Mosha mesatare e punëtorëve	48.35 %	48.55 %	%	%
Në marrëdhënie të rregullt pune	193	173	%	%
Me kontratë në kohë të pacaktuar	52	46	26.94 %	26.58 %
Me kontratë në kohë të caktuar	141	127	73 %	73.41 %
Meshkuj	167	149	86.52 %	86.12 %
Femra	26	24	13.47 %	13.87 %
Serbë	1	1	0.51 %	0.57 %
Shqiptarë	192	172	99.48 %	99.42 %

Me shkollim fillor	4	3	2.07 %	1.70 %
Me PM (përgatitje të mesme) shkollore	105	95	54.40 %	54.91 %
Me kualifikim profesional	22	20	11.39 %	11.56 %
Me përgatitje të lartë	2	2	1.03 %	1.15 %
Me përgatitje superiore	60	53	31.07 %	30.63 %
Zyrtarët e Lartë	4	4	2.28 %	2.31 %
Departamenti i Transportit të Mallrave	44	39	22.79 %	22.54 %
Departamenti i Transportit të Udhëtarëve	52	50	26.94 %	28.90 %
Departamenti i Administratës	41	33	21.24 %	19.07 %
Departamenti i Financave	7	7	3.62 %	4.04 %
Departamenti i Zhvillimit të Biznesit	5	5	2.59 %	2.89 %
Departamenti i Prokurimit	4	3	2.07 %	1.73 %
Kabineti i KE-së	2	1	1.03 %	0.57 %
Zyra e Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	14	12	7.25 %	6.93 %
Zyra për Marrëdhënie me Publikun	1	1	0.51 %	0.57 %
Zyra Ligjore	3	2	1.55 %	1.14 %
Zyra e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse	16	16	8.29%	9.24 %

Në bazë të të dhënave në tabelën me lart, shihet se numri i përgjithshëm i punëtorëve më datën 01.01.2024 ka qenë 193, ndërsa më datën 31.12.2024 ka qenë 173 punëtorë.

Vërejtje: Në tabelën e cekur më lart nuk janë përfshirë anëtarët e Bordit të Drejtorëve.

IX. PROCEDURAT GJYQËSORE

IX.1. Kontestet gjyqësore

Gjatë periudhës kohore janar – dhjetor 2024, nga Zyra Ligjore e Ndërmarrjes janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për përfaqësim sa më të mirë në çështjet ligjore pranë të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës. Në tabelën si më poshtë janë paraqitur seancat e mbajtura, veprimet që janë ndërmarrë në cilësinë e paditësit, të paditurit, kreditorit dhe debitorit, si dhe aktvendimet e aktgjykimet e gjykatave.

	Përshkrim	Vlera në €
1.	Gjatë vitit janë mbajtur 22 seanca dhe kemi pranuar 21 thirrje për seanca.	
2.	Me datë 16.10.2024 nga Përmbaruesi Privat I.Sh. kemi pranuar Urdhër Përmbarimor P.nr.02/2024, të kreditorit NTSH- E. ndaj debitorit H.K-Trainkos Sh.A., ku përfundohet procedura në këtë çështje përmbarimore, për shkak të përmbushjes së kredisë së kreditorit.	30,553.78
3.	Email Përmbaruesit Privat E.M.; kemi kërkuar të na njofton me gjendjen e lëndës P.nr.315/23, vlera 2010.00 €, Kreditor Trainkos Sh.A., Debitor H.K, nuk kemi pranuar ndonjë pagesë apo faturë në lidhje me lëndën, po ashtu na është përgjigjur se janë paguar dy këste.	2,010.00
4.	Me datë 22.10.2024 Gjykata Themelore në Prishtinë; lëndë përmbarimore C.nr.1969/18, sipas propozimit të propozuesit Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A., kundër kundërshtarit të sigurimit N.D. për caktimin e masës së sigurisë merr këtë: Aktvendim ; Hedhet poshtë propozimi i propozuesit Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A., kundër kundërshtarit të sigurimit N.D. për caktimin e masës së sigurisë i datës 07.10.2024 si i palejuar.	71,290.52
5.	Me datë 23.07.2024 nga Avokatura I. Sh.p.k, pranuar Ankesë ; lënda; kompensim i pagave jubilarë C.nr.2425/19, paditës J.H.e paditur H.K-Trainkos Sh.A.	1,435.40
6.	Me datë 01.11.2024 Gjykata Themelore në Prishtinë ; Aktvendim ; lënda kompensim dëmi C.nr.1377/2013 paditëse H.K-Trainkos Sh.A., I paditur A. I. ku të paditurit me adresë të panjohur i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm B. A. avokat në Prishtinë në këtë çështje juridike kontestimore/ lidhur me këtë aktvendim gjykata brenda afatit prej 7 ditësh do t'jap shpallje në gazetën zyrtare dhe publikohet në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate. Meqenëse aktvendimi për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm duhet të shpallet në Gazetën Zyrtare dhe atë në gjuhën Shqipe, Angleze dhe Serbe.	2,455.00
7.	Shpenzime për përkthim të Aktvendimit C.nr.1377/13 në gjuhën serbe dhe angleze kanë qenë 94.40 € dhe shpenzime tjera gjyqësore 31.00 €.	425.40
8.	Me datë 28.11.2024 seancë në Gjykatën Themelore Civile në Maqedonin e Veriut; lënda; kompensim dëmi, numri I lëndës 58 PL-TS-7/23, paditëse Hekurudhat e Maqedonis së Veriut, e paditur Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A./ deklarime të palëve; gjykata merr Aktvendim ; seanca e sotme nuk mbahet për shkak të mos plotësimit të kushteve procedurale. Gjykata; Aktvendim seanca do mbahet me datë 20.03.2025 në ora 10:30.	18,724.05

9.	Me datë 07.11.2024 Gjykata Themelore në Glllogoc; Aktvendim ; lënda C.nr.463/2023 paditë H.Xh., e paditur H.K-Trainkos Sh.A.,Gjykata merr Aktvendim ; Gjykata Themelore Glllogoc, <i>shpallet Jokompetente</i> pikëpamje territoriale për procedimin e kësaj çështje juridiko-civile. Padia i dërgohet në kompetencë Gjykatës Themelore në Fushë Kosovë.	Nuk ka vlerë.
10.	Me datë 12.12.2024 Gjykata Themelore në Pejë; thirrje për seancë gjyqësore; lënda; kompensim dëmi C.nr.609/21, paditës R.L., e paditur Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A.	9,900.00
11.	Me datë 30.05.2024 Gjykata Themelore në Glllogoc Aktgjykim ; lënda C.nr.172/2022 paditës H.K etj, e paditur H.K.-Trainkos Sh.A.,konstatohet se padia e paditësve H.K etj ndaj Trainkos Sh.A., është tërhequr ; lënda shkon në a/a.	100,000.00
12.	Me datë 24.06.2024 Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë; Përgjigje në bazë të kërkesës ; bërë në ARBK në lidhje me informatat e lëndës NT- H.,dhe në lidhje me pornarin e kesaj firme. Pas verifikimit na është njoftuar se biznesi i kërkuar me emrin NT-H. nuk ekziston në regjistër.	48,526.00
13.	Me datë 10.06.2024 Gjykata Komerciale në Prishtinë; ftesë për seancë të ndërmjetsimit ; lënda KE.nr.564/22, paditëse H.K- Trainkos Sh.A, e paditur C.Shpk, “Pasurim i pabazë” që të zgjidhet përmes ndërmjetësimit si procedure alternative me datë 26.06.2024 në ora 10:30.	7,913.22
14.	Me datë 15.10.2024 pjesëmarrje në seancë në Gjykatën Themelore në Glllogocë, në lëndën C.nr.79/14, paditës B.M. e paditu H.K- Trainkos Sh.A; Aktvendim ; seanca nuk mbahet për shkak të mos plotësimit të kushteve procedurale, po ashtu në procedurë përkatësisht të autorizuarit e paditësve lëndën e kanë marrë rishtazi dhe të njëjtit të kenë kohë për përgatitjen e saj.	66.000.00
15.	Me datë 12.09.2024, përgjigje në padi në Gjykatën Themelore në Klinë në lëndën C.nr.61/20, paditës F.H. , e paditur H.K-Trainkos Sh.A.	Vlera e pavërtetuar
16.	Me datë 07.10.2024 Gjykata Komerciale e Kosovës; Aktvendim ; lënda KPPP.nr.1795/23, të kreditorit B.- Shpk , kundër debitorit H.K-Trainkos Sh.A. Pranohet si I bazuar prapësimi I debitorit Trainkos Sh.A. dhe Anulohet Aktvendimi E.nr.602/14 I datës 25.04.2014 I lejuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe Përfundohet në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.	23,639.53
17.	Me datë 26.12.2024, seancë në Gjykatën Themelore në Pejë; lënda C.nr.1051/20, paditës T. D., e paditur H.K-Trainkos Sh.A., pas publikimit të lëndës në mos marrjen pjesë në tri seancat e fundit nga pala paditëse Gjyqtari ekonsideron të tërhequr padinë.	15.000.00
18.	Me datë 12.11.2024, seancë në Gjykatën Komerciale në Prishtinë; lënda; 229/23, paditëse H.K-Trainkos Sh.A., i paditur L.-SHPK, pas deklarimeve të palëve Gjykata merr Aktvendim ; palët nuk kanë propozime tjera në seancën e ardhëshme gjykata do të vazhdojë me administrimin e provave dhe fjalën përfundimtare.	16.703.00
19.	Me datë 16.10.2024, Gjykata Komerciale e Kosovës; Aktvendim ;lënda KPPP.nr.1815/23, të kreditorit D.K kundër debitorit H.K-Trainkos Sh.A. Përfundohet pjesërisht procedura përmbarimore e kreditorit D.K., ndaj debitorit Trainkos Sh.A.,sipas Aktvendimit për lejimin e përmbarimit E.nr.1421/13 të datës 09.03.2020 për detyrimin kryesor në shumën prej	1,000.00

	1,000.00euro për shkak të përmbushjes së detyrimit kryesor.	
20.	Me datë 23.10.2024, seancë GJ. Komerciale në Prishtinë; Aktvendim Pasurim I pabazë KE.nr.634/22, paditsi H.K-Trainkos Sh.A., e paditura R. P.-Shpk; caktohet marrja e proves përmes ekspertizës financiare sipas detyrës zyrtare , ku për ekspert caktohet z.A.Sh. dhe detyrohet paditësi që në emër të paradhënies për shpenzimet e ekspertizës nga ana e ekspertit të makinerisë, brenda afatit prej 7 (ditësh) nga dita e shpalljes së këtij aktvendimi të deponoj në arkën e Gjykatës Themelore në Prishtinë shumën në lartësi prej 300.00€ (tre qind euro).	47,311.40
21.	Me datë 07.11.2024, Gjykata Themelore në Prishtinë, Aktvendim ;lënda Cpc.nr.419/22, kreditor I. Sh., debitor H.K Trainkos Sh.A. Aprovohet prapësimi i debitorit Trinkos Sh.A.; shfuqizohet Aktvendim Cpc.419/22 I datës 08.11.2024 për lejimin e përmbarimit, lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe përfundohet procedura përmbarimore.	8,948.00
22.	Me datë 29.11.2024 Gjykata Themelore në Pejë; thirrje për seancë ; lëndën C.nr.184/23,paditës G.B, e paditur H.K-Trainkos Sh.A., me datë 30.12.2024 në ora 13:00.	4,500.00

Tabela 8.1

IX.2. Kontestet gjyqësore për vitin 2025

Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A. gjatë vitit 2024, janë ballafaquar me **62** konteste gjyqësore. Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve dhe kategorizimi i tyre për të cilat janë zhvilluar veprime procedurale të përshkruara sipas aktivitetit në tabelën e mësipërme.

Nr.	LLOJET E KONTESTEVE	////////
1.	Kontestet e marrëdhënies së punës	9
2.	Kontestet për kompensim të dëmit	27
3.	Kontestet për pagimin e borxhit	5
4.	Kontest nga Konflikti Administrativ	1
5.	Lëndë në procedurë përmbarimore	20
6.	Lëndë në procedurë penale	
	Totali	62

Tabela 8.2.

X. PËRFUNDIM

HK-Trainkos Sh.A gjatë vitit 2024, përkundër përpjekjeve e angazhimit, nuk ka arritur që të përmbush planifikimet dhe objektivat e përcaktuara në Planin e Biznesit për këtë vit. Pengesat kanë qenë nga më të ndryshmet, probleme të vjetra e të shumta janë bërë pengesë në realizimin e planifikimeve dhe në zhvillimin e Ndërmarrjes.

Megjithatë, përkundër të gjitha vështirësive, disa prej sukseseve të arritura nga masat e ndërmarra gjatë këtij viti janë premtuese për Ndërmarrjen, të domosdoshme po ashtu kanë qenë për tejkalimin e gjendjes së vështirë të saj. Shkurtime buxhetore dhe shfrytëzimi racional i resurseve tjera të Ndërmarrjes, kanë ndikuar në shkallë të lartë në sanimin e gjendjes dhe zvogëlimin e shpenzimeve në vitin 2024.

Pengesat që janë shfaqur nga realizimi i projektit në rehabilitimin e Linjës së 10-të Hekurudhore pothuajse janë afër tejkalimit, këtë vit presim që Linja e Hanit të Elezit të jetë e gatshme për operim. Me fillimin e transportit hekurudhor në këtë linjë për Trainkos-in do të hapen mundësi të reja, por njëkohësisht do të shtohen edhe sfidat.

Gjendja e mjeteve lëvizëse hekurudhore të Ndërmarrjes, të cilat janë të vjetruara e të pakta në numër, padyshim që rrisin kërkesën dhe nevojën për ripërtëritjen e tyre. Procesi i avancimeve në sistemin hekurudhor, së bashku me planifikimet strategjike të BE-së për funksionalizimin e Rrjetit Bazik Hekurudhor të Evropës, si dhe kërkesat që lindin nga nevoja për reformimin e këtij sistemi në Evropën Juglindore, kërkojnë përgatitje të duhur për realizimin e tij, përfshirë edhe mjete lëvizëse hekurudhore në përputhje me standardet. Plotësimi i kriterëve të Interoperabilitetit përmes TSI dhe plotësimi i kriterëve/kërkesave që vijnë përmes Planit të Veprimit për Mekanizmin Stabilizim Asociim (PVMAS) dhe kërkesat tjera që Trainkos-i duhet t'i plotësojë si pjesë përbërëse e sistemit hekurudhor të Republikës së Kosovës, kjo është dhe do të jetë sfiduese.

Besojmë se me mbështetjen edhe të Aksionarit, do të gjejmë rrugë e mundësi për investime në mjetet lëvizëse, qoftë përmes granteve apo përmes formave tjera të financimit nga institucionet financiare.

Përkushtimi i përhershëm mbetet në angazhimet tona të përditshme për zhvillimin e mëtutjeshëm të Ndërmarrjes në ofrimin sa më të mirë të shërbimeve tona për klientët tanë.

Fushë Kosovë,

Mars 2025

Agron Statovci
[Signature]
Kryeshef Ekzekutiv

